

**AKT THEMELIMIT DHE STATUT**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**CENTRIC SHPK**

Në datën 25 Janar 2023, unë Arjola Koromani themeluesi i vetëm, kam krijuar shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin Centric shpk (në vijim “Shoqëria”)

**NENI 1**

**ORTAKËT**

Ortaku i vetëm i shoqërisë është Arjola KOROMANI, e bija e Xhaferr-it, lindur më 09/05/1988, në Krastë dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e identifikuar me dokument identifikimi me Numër Personal I85509067A.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia qendrore e shoqërisë është në adresën: Rruga “Tefta Tashko”, Pazari i Ri, Nr. 185, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë.

Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në Tiranë dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashtë vendit.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.



## NENI 4

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

- Zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie Web-site etj.
- Shërbim akses interneti.
- Shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit.
- Sistem informatik për regjistrimin fillestar të pronave, përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave.
- Zhvillim dhe implementim të sistemeve të informacionit gjeografik (GIS), regjistrim të pasurive të paluajtshme, planifikim urban, hartografi dhe matje topogjeodezike.
- Hostim i faqeve të aplikacioneve.
- Regjistrimi dhe Administrimi i Emrave dhe Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”

Shoqëria mund të ushtrojë çdo veprimtari tjetër tregëtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj.

## NENI 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë ose zvogëlojë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie.

## NENI 6

### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është 1 000 (Një mijë) Lekë në një kuotë të vetme dhe zotërues i kuotës është ortaku i vetëm i shoqërisë.

## NENI 7

### DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## NENI 8

Asambleja e Ortakëve mund të vendos të tërheq kapitalin e derdhur në cdo kohë që e konsideron të nevojshme.

## NENI 9

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

Asambleja e ortakëve mund të marr vendim për transferimin e kuotave personave te tretë.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Kjo kontratë dërgohet në selinë e shoqërisë.

Administratori mund të refuzojë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKB në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose për shkak të rrethanave të tjera që e bëjnë të pamundur këtë regjistrim.

Nëse Administratori refuzon regjistrimin e kalimit të kuotës, ai njofton Asamblenë e Përgjithshme brenda një afati 5 (pesë) ditor nga data në të cilën është paraqitur kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

## **NENI 10**

Emërtimi i shoqërisë tregtare dhe emri i administratorit të shoqërisë duhet të jetë i pasqyruar në aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

## **NENI 11**

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore. Ortaku i shoqërisë drejton procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Organet e shoqërisë janë:

1. Asambleja e Ortakëve
2. Administratori

## **NENI 12**

### **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

Asambleja e Ortakëve ushtron funksionet e mëposhtme:

- Përcakton e politikat tregtare të shoqërisë;
- Ndryshon statutin;
- Emëron dhe shkarkon Administratorin;
- Emëron dhe shkarkon likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Mund të zmadhojë dhe zvogëlojë kapitalin;
- Pjesëton kuotat dhe bën anulimin e tyre;
- Përfaqëson shoqërinë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorit;
- Riorganizon dhe shpërbën shoqërinë;
- Miraton rregullat procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga Administratori nëse është thirrur prej tij.



Administratori pavarësisht se mund të mos jetë ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në cdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 13**

Marrja e vendimeve të Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentet e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

#### **NENI 14**

### **EMËRIMI I ADMINISTRATORIT**

Administrimi si dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohet një Administratori.

Administratori emërohet për 5-vjet nga regjistrimi i shoqërisë pranë QKB-së me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim dorëheqjen apo shkarkimin nga ana e Asamblesë.

Administrator i shoqërisë është ortaku i vetëm i shoqërisë, Arjola KOROMANI shtetase shqiptare, lindur datë 09/05/1988 në Skrapar, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me dokument identifikimi me Numër Personal I85509067A.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë në cdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme votash, me kusht që në mbledhje të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë të paktën 30% të kuotave.

#### **NENI 15**

### **PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT**

- Është përfaqësuesi ligjor i Kompanisë;
- Menaxhon në përditshmëri Kompaninë, miraton vendime që mund të konsiderohen të përshtatshme për të arritur objektivat e Kompanisë në përputhje me rezolutat dhe udhëzimet e Asamblesë së Ortakëve;
- Nënshkruan kontratat e përgjithshme për furnizime publike-private në përputhje me parashikimet e Statutit;



- Jep prokura të posacme dhe të përgjithshme si dhe autorizime në kufijtë që i lejon Asambleja e Përgjithshme;
- Hap llogaritë bankare të shoqërisë;
- Lidh marrëveshje me palët e treta;
- Lëshon fatura dhe shlyen llogaritë e pagueshme të Kompanisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- Ndërmerr të gjitha veprimet e tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e biznesit të zakonshëm të Shoqërisë;
- Raporton periodikisht te Asambleja e Ortakëve.

## **NENI 16**

### **MARRËDHËNIET E PUNËS**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## **NENI 17**

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjith aktëve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratori dhe ortaku i kësaj shoqërie.

## **NENI 18**

### **EKSPERTËT OSE REVIZORËT KONTABËL**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të veçanta ligjore.



## **NENI 19**

### **BILANCI DHE FITIMET**

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në datë 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si më sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mund t'i shpërndahen ortakut dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

## **NENI 20**

Në rast se kapitali i shoqërisë rezulton më pak se kapitali themeltar, Asambleja e Ortakëve vendos brenda 4 muajve mundësinë e prishjes së shoqërisë.

## **NENI 21**

### **SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Në rast se shoqëria prishet për çdo lloj arsye Asambleja e Ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentat e nevojshme për çregjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

## **NENI 22**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Për sa është shprehur, në këtë statut i referohemi ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar si dherregullores s Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar brendshme të shoqërisë. Çdo ndryshim bëhet në të njejtën mënyrë siç është nxjerrë ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

## **ORTAKU I VETËM**

I

### **SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**

CENTRIC shpk  
Arjola KOROMANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



V2023053790065577183

DATE 25/01/2023

NR REP 768 /d

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 25.01.2023 vërtetoj nënshkrimin e Themeluesit të vetem të shoqërisë “CENTRIC” Shpk, përfaqësuar nga Themeluesja e vetme **znj. Arjola Koromani**, atësia Xhaferr, amësia Qëndrime, shtetase Shqiptare, lindur në Krastë, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë Anasoni 03920030; Nd. 11; H. 2; Kashar; Yzberish, 1050; Tiranë, lindur më 09/05/1988, gjendja civile “beqare”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032886503 dhe nr. personal I85509067A , , .

E cila deklaron se Dokumentat e shoqërisë janë nënshkruar prej saj dhe unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personit të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE  
Majlinda E. Demollari  
NDP 71 K416/0040/A  
Jeh 0882001566